



Rregulla për sjellje në Gjykatën Themelore Shkupi I

1. Paralajmërohen vizitorët se hyjnë në ndërtesën e gjykatës dhe se nevojitet që t'ju përmbahen standardeve përkatëse për sjellje. Secili që nuk do t'ju përmbahet rregullave të gjykatës ose nuk do t'ju përmbahet standardeve për sjellje do të largohet nga ndërtesa e gjykatës.
2. Nuk është e lejuar hyrja në ndërtesën e gjykatës personave të cilët nuk i kanë mbushur 18 vjet, përveç me leje ose urdhër të gjykatës, në prani të personit të rritur ose me leje nga administrata e gjykatës.
3. Vizitorët të cilët marrin pjesë në seancë kryesore do të vendosen në vendet për publik. Kryetari i këshillit gjyqësor mund të urdhërojë përjashtim të personit nga vendet për vizitorë nëse e njëjta shkakton ndërprerje ose prishje të rendit në gjykatë.
4. Vizitorët patjetër duhet të ngriten në këmbë gjatë hyrjes së gjykatësit në gjykimore.
5. Për kohëzgjatjen e seancës kryesore vizitorët të jenë të qetë dhe t'i përmbahen instruksioneve të dhëna nga policia gjyqësore.
6. Për kohëzgjatjen e seancës kryesore ndalohen bisedat ndërmjet vizitorëve, zhurma, sjellja e ofenduese, e dhunshme ose çfarëdo aktiviteti me të cilin do të prishej zhvillimi i pandërprerë i punës së gjykatës.
7. Është e obliguar që personat të cilët hyjnë në gjykatë të jenë të veshur në mënyrë adekuate. Veshja e cila do të konsiderohet si provokative, shqetësuese ose veshje e cila ka shenja ose fotografi ofenduese është e ndaluar.
8. Gjatë hyrjes në gjykimore ndalohet mbajtja e telefonëve celularë, kompjuterëve të lëvizshëm, PDA, kamerave ose çfarëdo audio dhe video pajisje e cila mund të incizojë ose të procesojë. Këto sende të lihen në sirtarët të vendosur për atë qëllim.
9. Audio dhe video incizimi, pa lejen nga administrata janë rreptësisht të ndaluara në ndërtesën e gjykatës. Policia gjyqësore është e autorizuar që të konfiskojë dhe/ose t'i fshijë incizimet e pautorizuara.
10. Pirje, ushqim, konsumim i duhanit ose përdorim i mjeteve narkotike ndalohen në ndërtesën e gjykatës.
11. Vizitorët nuk guxojnë të lënë bagazh ose sende personale pa mbikqyrje. Vizitorëve të cilët fusin bagazh të parëndomtë dhe të tepërt mund që mos t'ju lejohet hyrja. Gjykata nuk merr kurrfarë përgjegjësie për çfarëdo lloj sendeve personale të vizitorëve të humbura, të dëmtuara ose të vjedhura derisa janë në ambientet e gjykatës.
13. Policia gjyqësore mund të thërrasë në evakuim të ndërtesës së gjykatës në çdo kohë. Ju lutem ndiqni dhe përmbahuni instruksioneve të tyre..